



Numri: KSC-BC-2020-05
Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës

Para: Gjykatësit të procedurës paraprake
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrës parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 1 tetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Parashtrime lidhur me sistemin e redaktimit

Zyra e Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësi i të akuzuarit
Julius von Bóné

I. HYRJE

1. Në përputhje me Urdhrin¹ e gjykatësit të procedurës paraprake, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS') ofron parashtrime lidhur me sistemin e redaktimit. ZPS-ja kërkon nga gjykatësi i procedurës paraprake të miratojë sistemin e redaktimit në pajtim me të cilin palët mund të redaktojnë informacion që përmbajnë materialet që përfshihen brenda detyrimeve të tyre për nxjerrje të informacioneve sipas nenit 21(6) të Ligjit² dhe rregullave 102-104³ dhe në përputhje me një grup kategorish të miratuara paraprakisht.

2. Sistemi i propozuar do të rrisë efikasitetin e procesit gjyqësor, dhe në veçanti, shpejtësinë e procesit të nxjerrjes së materialit, duke siguruar në të njëjtën kohë që procesi gjyqësor të kryhet duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarve dhe duke i kushtuar vëmendjen dhe kujdesin e duhur mbrojtjes së dëshmitarëve, viktimave dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të aktiviteteve të gjykatës. Një sistem i tillë redaktimi gjithashtu rrit mundësitë për panelet gjyqësore në të gjitha fazat e procesit që në mënyrë efektive dhe efikase të ushtrojnë mbikëqyrjen e procesit të nxjerrjes së materialit, siç kërkohet sipas Ligjit dhe Rregullores.

II. PARASHTRIMET

3. Duke u mbështetur në përvojën e mbledhur dhe praktikave të tjera,⁴

¹ Urdhër për parashtrime mbi sistemin e redaktimit, KSC-BC-2020-05/F00022, 28 shtator 2020, publik ('Urdhër').

² Ligji nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyren e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'). Të gjitha përmendjet e termit 'neni' ose 'nenet' i referohen neneve të Ligjit, përveçse kur specifikohet ndryshe.

³ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Të gjitha përmendjet e termit 'rregulla' ose 'rregullat' i referohen Rregullores, përveçse kur specifikohet ndryshe.

⁴ Shih, për shembull, International Criminal Court ('ICC'), Chambers Practice Manual (December 2019), pp.31-34; ICC, *Prosecutor v. Yekatom*, ICC-01/14-01/18-64-Red, Public Redacted Version of 'Decision on Disclosure and Related Matters', 23, January 2019, paras 23-26. *Shih gjithashtu* ICC, Chambers Practice Manual (May 2017) p.3 (duke vërejtur se manuali përfshirë sistemin e redaktimit, pasqyron praktikave më të mira bazuar në 'përvojën dhe ekspertizën e gjykatësve nga të gjitha gjykimet në Gjykatë') dhe p.28-30 (ku trajtohet sistemi i redaktimit).

dhe në pajtim me kornizën ligjore të zbatueshme,⁵ gjykatësi i procedurës paraprake⁶ duhet të miratojë sistemin e redaktimit në pajtim me të cilin pala që nxjerr materialin: (i) zbaton redaktimet në përputhje me një grup kategorish (dhe arsyetimet përkatëse) të cilat janë miratuar paraprakisht nga gjykatësi i procedurës paraprake; (ii) i heq këto redaktime në përputhje me afatet e caktuara, miratuar nga gjykatësi i procedurës paraprake; dhe (iii) kërkon miratimin sipas rasteve individuale për redaktimet e tjera që nuk u përkasin kategorive të identifikuar. Riorganizimi i sistemit të redaktimit në këtë mënyrë është thelbësor për të siguruar procedura të drejta e të shpejta, në veçanti për procesin e nxjerrjes së materialit. Ky sistem ofron një proces të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm përgjatë tërë fazave të procedurës paraprake dhe të gjykimit, ku palët dhe paneli kanë mirëkuptim të ndërsjellë për natyrën e redaktimeve të zbatuara, duke lehtësuar në këtë mënyrë një mbikëqyrje më të mirë dhe më efektive gjyqësore të procesit të nxjerrjes së materialit.

4. Sistemi i redaktimit i përmbledhur më poshtë i arrin këto qëllime. ZPS-ja kërkon nga gjykatësi i procedurës paraprake që të miratojë kategoritë e redaktimit në vijim që do të zbatoheshin drejtpërdrejtë nga pala që nxjerr materialin:

Kategoria A: Mbrojtja e hetimeve të ardhshme ose hetimeve në kryerje e sipër (Rregulla 108(1)(a)).

Kategoria A.1: Vendndodhjet e intervistave dhe të akomodimit

- *Arsyetim:* Nxjerrja e materialit tërheq vëmendjen në mënyrë të papërshtatshme ndaj lëvizjeve të palëve, personelit, viktimave, dëshmitarëve dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të aktiviteteve të gjykatës dhe paraqet rrezik objektiv për hetimet në kryerje e sipër apo hetimeve të ardhshme.

⁵ Shih nenet 21(6) dhe 35(2)(f) dhe rregullat 80, 106, 108 dhe 111 (që përcaktojnë informacionin që përjashtohet nga nxjerrja e materialit, ndër të tjera për mbrojtjen e personave të rrezikuar dhe shmangien e dëmtimit të hetimeve).

⁶ Neni 39(1) dhe(3) dhe rregulla 95 (që përcaktojnë kompetencën e gjykatësit të procedurës paraprake për lëshimin e urdhrave të tillë të nevojshëm për përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë, duke përfshirë edhe nxjerrjen e materialeve në kohë)

Redaktimi u mundëson palëve të vazhdojnë me përdorimin e këtyre vendeve në mënyrë të sigurt. Në parim, informacioni nuk është i rëndësishëm për palën tjetër.

- *Afati*: Redaktimet e këtij informacioni duhet të hiqen atëherë kur vendi nuk përdoret më për hetimet në kryerje e sipër apo për hetimet e ardhshme.

Kategoria A.2: Punonjësit dhe kontraktuesit

- *Informacioni për redaktim*: Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të palës, Zyrës Administrative apo punonjësve të gjykatës apo të kontraktuesve (përpos hetuesve), të cilët udhëtojnë shpesh, apo janë të bazuar në terren.
- *Arsyetim*: Nxjerrja e këtyre të dhënave mund të rrezikojë personat dhe/ose hetimet në kryerje e sipër. Duke marrë parasysh punën në kryerje e sipër ose punën e ardhshme në terren të këtyre individëve, çfarëdo ndërhyrje ndaj tyre do të rrezikonte hetimet në kryerje e sipër dhe/apo hetimet e mëtejshme.
- Pala që bën nxjerrjen e materialit njofton për punonjësit ose kontraktuesit në përputhje me kodet në vijim:
 - A.2.1: përkthyesit;
 - A.2.2: stenografët;
 - A.2.3: ekspertët psiko-socialë;
 - A.2.4: ekspertët e tjerë mjekësorë;
 - A.2.5: punonjës të tjerë në këtë kategori;
 - A.2.6: kontraktues të tjerë në këtë kategori.

Kategoria A.3: Hetuesit

- *Informacioni për redaktim:* Të dhëna identifikuese dhe të kontaktit të hetuesve.
- *Arsyetimi:* Palët kanë një numër të kufizuar hetuesish. Gjatë punës së tyre, hetuesit në veçanti, punojnë në çështje të ndryshme që përfshijnë vende të ndryshme dhe të akuzuar të ndryshëm. Nxjerrja e identitetit të hetuesve mund të rrezikojë personat dhe/ose hetimet në kryerje e sipër. Gjithashtu, kjo mund të paraqesë rrezik për sigurinë e dëshmitarëve, apo personave të tjerë, që ata marrin në pyetje ose që kontaktojnë.
- Në përputhje me paragrafin 6 më poshtë, pala që nxjerr materialin, krahas kodit të kategorisë (p.sh. A.3.1., A.3.2., A.3.3. etj), bën të ditur pseudonimin unik të hetuesit.

Kategoria A.4: Ndërmjetësuesit

- *Informacioni për redaktim:* Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të ndërmjetësuesve.
- *Arsyetim:* Nxjerrja e këtyre të dhënave mund të rrezikojë personat dhe/ose hetimet në kryerje e sipër. Gjithashtu mund të paraqesë rrezik për sigurinë e dëshmitarëve dhe personave të tjerë me të cilët ata kanë kontakt. Mosnxjerrja e të dhënave siguron që ndërmjetësuesit mund të vazhdojnë të ndihmojnë palën që bën nxjerrjen e materialit gjatë hetimeve të saj në mënyrë të sigurt dhe të efektshme.
- Në përputhje me paragrafin 6 më poshtë, pala që nxjerr materialin, krahas kodit të kategorisë (p.sh. A.4.1., A.4.2., A.4.3., etj), bën të ditur pseudonimin unik të ndërmjetësuesit.

Kategoria A.5: Sinjalizuesit dhe burimet

- *Informacioni për redaktim:* Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të sinjalizuesve dhe burimeve.
- *Arsyetimi:* Të sigurohet se ata nuk do të jenë objekt i frikësimeve ose ndërhyrjeve, çka mund të dëmtojë hetimet në kryerje e sipër dhe hetimet e ardhshme.
- Kur sinjalizuesi ose burimi ofron informacion që është nxjerrë dhe në qoftë se nuk ekzistojnë shqetësime shtesë për sigurinë dhe sinjalizuesi ose burimi nuk është i mbrojtur me nenin 35(2)(e) të Ligjit dhe rregullën 107, identiteti i sinjalizuesit duhet të bëhet i ditur në kontekstin e kësaj nxjerrjeje të informacionit.
- Pala që bën nxjerrjen e informacionit do të bëjë të ditur sinjalizuesit dhe burimet në përputhje me kodet e kategorive në vijim:
 - A.5.1: Individë;
 - A.5.2: Organizata joqeveritare;
 - A.5.3: Organizata ndërkombëtare;
 - A.5.4: Agjenci shtetërore qeveritare;
 - A.5.5: Institucione akademike;
 - A.5.6: Kompani private; dhe
 - A.5.7: Burime të tjera.

Kategoria A.6: Mjetet që përdoren për të komunikuar me dëshmitarët

- *Arsyetim:* Nxjerrja e materialit mund të komprometojë teknikat hetimore dhe vendndodhjen e dëshmitarëve. Në parim, informacioni nuk është i rëndësishëm për palën tjetër.

Kategoria A.7: Redaktimet e tjera sipas rregullës 108(1)(a)

- *Arsyetim:* Nxjerrja e materialit mund të dëmtojë hetimet në kryerje e sipër apo hetimet e ardhshme.

Kategoria B: Mbrojtja e viktimave, dëshmitarëve, anëtarëve të familjeve të tyre dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të aktiviteteve të gjykatës (Rregulla 108(1)(b)-(c)).⁷**Kategoria B.1: Të dhënat e kontaktit të dëshmitarëve**

- *Informacioni për redaktim:* Të dhënat e kontaktit, përfshirë numrat e telefonit, vendbanimet/adresat dhe postën elektronike(email).
- *Arsyetim:* Mosnxjerrja e këtyre të dhënave është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, dinjitetin, privatësinë dhe mirëqenien e personit përkatës.

Kategoria B.2: Të dhënat identifikuese dhe ato të kontaktit të anëtarëve të familjes së dëshmitarëve

- *Informacioni për redaktim:* Të dhënat identifikuese të anëtarëve të familjes apo personave të tjerë të rrezikuar, përfshirë fotografitë, si dhe të dhëna kontakti

⁷ *Shih, per shembull, ICC, Appeals Chamber, ICC-01/04-01/07-475, Judgment on the Appeal of the Prosecutor against the Decision of Pre-Trial Chamber I entitled 'First Decision on the prosecution request for authorisation to redact witness statements', 13 May 2008, para.56 (që interpreton gjuhë të ngjashme për të përfshirë 'personat e tjerë të rrezikuar për shkak të aktiviteteve të gjykatës' në mënyrë që të pasqyrojë qëllimin për të mbrojtur individët e rrezikuar).*

përfshirë numrat e telefonit, vendbanimet/adresat dhe postën elektronike(email).

- *Arsyetim:* Anëtarët e familjes së dëshmitarëve janë skajshmërisht të cenueshëm duke pasur parasysh se ata nuk janë pajtuar të jenë pjesë e procesit gjyqësor (dhe mund të mos jenë në dijeni për këtë) dhe ekziston rreziku se mund të shihen sikur kanë lidhje me gjykatën. Mosnxjerrja e këtyre të dhënave është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, dinjitetin, privatësinë dhe mirëqenien e anëtarëve të familjes.
- *Afati:* Redaktimet e të dhënave të kontaktit duhet të jenë të vazhdueshme. Kur redaktimi i të dhënave identifikuese zbatohet vetëm për të mbrojtur një dëshmitar për të cilin redaktimet nuk janë më të përligjura, redaktimet duhet të hiqen atëherë kur identiteti i dëshmitarit bëhet i ditur. Në rastet kur redaktimi i të dhënave identifikuese zbatohet për shkak të vetë sigurisë së anëtarit të familjes dhe identiteti i këtij anëtari të familjes nuk ka rëndësi për asnjë aspekt të njohur të çështjes, redaktimet në këtë kategori duhet të jenë të vazhdueshme. Për redaktimet të cilat nuk janë si rastet e lartpërmendura, pala që bën nxjerrjen e informacioneve duhet t'i bëjë kërkesë panelit përkatës.

Kategoria B.3: Të dhënat identifikuese dhe ato të kontaktit të 'palëve të treta të pafajshme'

- *Informacioni për redaktim:* Të dhënat identifikuese dhe ato të kontaktit të personave të tjerë të rrezikuar si rezultat i aktiviteteve të gjykatës, përfshirë numrat e telefonit, vendbanimet/adresat, postën elektronike (email) dhe fotografitë.
- *Arsyetim:* Këta individë nuk janë pajtuar të jenë pjesë e procesit gjyqësor në Dhomat e Specializuara të Kosovës (dhe mund të mos jenë në dijeni për këtë) dhe rrezikojnë të perceptohen si dëshmitarë të mundshëm apo bashkëpunëtorë

të gjykatës. Mosnxjerrja e këtyre të dhënave është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, dinjitetin, privatësinë dhe mirëqenien e tyre.

- *Afati*: Redaktimet e të dhënave të kontaktit duhet të jenë të vazhdueshme. Për individët të cilët nuk kanë rëndësi për asnjë aspekt të njohur të çështjes, redaktimet e të dhënave identifikuese duhet të jenë të vazhdueshme. Përndryshe, pala që bën nxjerrjen e informacioneve duhet të bëjë kërkesë para panelit përkatës.

Kategoria B.4: Vendndodhja e dëshmitarëve të pranuar në programin për mbrojtje të dëshmitarëve

- *Informacioni për redaktim*: Vendndodhja e dëshmitarëve të pranuar në programin për mbrojtje të dëshmitarëve dhe informacionet që zbulojnë vendet që përdoren për zhvendosjen e dëshmitarëve të tillë, aktualisht dhe në të ardhmen (përfshirë kohën para përfshirjes në programin për mbrojtje të dëshmitarëve).
- *Arsyetim*: Konfidencialiteti i këtyre vendeve duhet të ruhet për të shmangur komprometimin e programit për mbrojtje dhe sigurinë e dëshmitarëve. Në parim, informacioni nuk është i rëndësishëm për palën tjetër.

Kategoria B.5: Redaktimet e tjera sipas rregullës 108(1)(b)-(c)

- *Arsyetim*: Nxjerrja e informacioneve mund të shkaktojë rrezik të rëndë për sigurinë e viktimave, dëshmitarëve, anëtarëve të familjeve të tyre dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të aktiviteteve të gjykatës apo mund të jetë në kundërshtim me interesin publik ose të drejtat e palëve të treta.

Kategoria C: Mbrojtja e raporteve, memorandumeve dhe dokumenteve të brendshme (Rregulla 106).

- *Baza ligjore*: Në përputhje me rregullën 106 dhe në varësi të rregullës 103, produkti i punës së brendshme nuk është objekt i nxjerrjes së materialit. Kur

produkti i punës së brendshme ekziston në material që është objekt i nxjerrjes, për redaktim të tillë nuk nevojitet miratimi i panelit, por ai duhet të identifikohet me kodin 'C' në materialin e nxjerrë.

Kategoria D: Mbrojtja e komunikimeve dhe informacioneve të privileguara (Rregulla 111(1)).

- o *Baza ligjore:* Në përputhje me rregullën 111(1), komunikimet e bëra në kontekstin e raportit profesional midis një personi dhe mbrojtësit të specializuar të atij personi nuk janë objekt i nxjerrjes së materialit, pos disa përjashtimeve të caktuara. Për redaktime të tilla nuk nevojitet miratimi i panelit, por ato duhet të identifikohen me kodin 'D' në materialin e nxjerrë. Redaktimet e kategorisë D nuk mund të zbatohen për informacionin e rregullës 111(2)-(6), por i duhet paraqitur kërkesë panelit përkatës.

5. Kur redaktimi specifik i përket një prej kategorive të paraqitura më lart, pala që bën nxjerrjen e materialit duhet të përfshijë kodin përkatës në kutinë e redaktimit. Ky format i mundëson lexuesit që menjëherë të kuptojë llojin e informacionit origjinal që është redaktuar në tekst dhe arsyetimin përkatës. Në rast se informacioni i redaktuar i përket më shumë se një kategorie, duhen shënuar të gjitha kodet.

6. Për më tepër, për identitetin e redaktuar të personave të kategorive A.3 dhe A.4 duhet caktuar një pseudonim unik, i cili do të shoqërojë kodin përkatës të redaktimit. Qëllimi i pseudonimeve të tilla është që lexuesi i materialit të redaktuar të mund të përcaktojë nëse të njëjtit person i janë referuar në deklaratat të ndryshme. Pseudonimi nuk duhet të përfshihet nëse kjo bie ndesh me qëllimin e vetë redaktimit, por pala që bën nxjerrjen e informacionit duhet ta bëjë të qartë se cilat redaktime nuk përfshijnë pseudonimet për arsyen e lartpërmendur.

7. Redaktimet e kategorisë A-D, në pajtim me rregullën 106 dhe 108(1), duhet të zbatohen, *mutatis mutandis*, për informacione të barasvlershme nga agjenci të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare për zbatimin e ligjit, përfshirë policinë dhe prokurorinë

e Kosovës, TPNJ-në, KFOR-in, UNMIK-un dhe EULEX-Kosova.⁸ Kur zbatohen redaktime të tilla, përpos kodit përkatës të redaktimit duhet të përfshihet edhe identifikuesi për agjencinë në fjalë.

8. Redaktimet duhet të hiqen: (i) nga pala që bën nxjerrjen e materialit në përputhje me afatet përkatëse;⁹ (ii) me një marrëveshje midis palëve; ose (iii) me një urdhër të panelit që vendos ndryshe. Nëse informacioni i përket më shumë se një kategorie, redaktimi duhet të hiqet pas përfundimit të të gjitha afateve. Kur pala që bën nxjerrjen e materialit dëshiron të mbajë redaktimet edhe pas afatit përkatës për heqjen e redaktimit, ajo duhet t'i bëjë kërkesë panelit përkatës.

9. Nëse pala marrëse konsideron se një redaktim specifik është i panevojshëm ose nuk është më i përligjur dhe duhet të hiqet, ajo duhet t'i bëjë kërkesë palës që ka nxjerrë materialin sa më shpejt që është e mundur mbi bazë *inter partes*. Më tej, palët duhet të konsultohen në mirëbesim duke u munduar të zgjidhin çështjen. Në rast se nuk arrijnë të pajtohen, pala marrëse mund të kërkojë ndërhyrjen e panelit përkatës përmes një kërkesë me shkrim, duke krijuar në këtë mënyrë një obligim për palën nxjerrëse të materialit, që të arsyetojë redaktimin në fjalë.

10. Sistemi i redaktimit i paraqitur më lart nuk duhet të zbatohet në rastin e mosnxjerrjes së identitetit të dëshmitarëve para fillimit të gjykimit dhe në rastin e mosnxjerrjes së të gjitha provave. Në raste të tilla, pala duhet t'i parashtrojë një kërkesë të veçantë panelit përkatës. Kur pala që nxjerr materialin kërkon të zbatojë redaktimet të cilat nuk janë të bazuara në kategoritë e diskutuara më lart, pala që nxjerr materialin duhet të shënojë redaktimin me kodin 'E'. Nxjerrja e materialit përkatës duhet gjithashtu të shoqërohet me një kërkesë për panelin përkatës duke arsyetuar

⁸ *Shih* Ligji, Neni 37(1) që përcakton se provat e mbledhura nga entitete të tilla mund të jenë të pranueshme para Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, informacionet që bien brenda kategorive duhet të gëzojnë mbrojtje të njëjtë para Dhomave të Specializuara.

⁹ Kurdoherë që aktivizohet afati për heqjen e redaktimeve (ose përmes datës ose rrethanave), pala që nxjerr materialin do të heqë redaktimet dhe do të nxjerrë materialin përkatës pa kërkuar lejen paraprake të panelit, përveç nëse një kërkesë e tillë është e nevojshme sipas Ligjit, Rregullores apo urdhrit gjyqësor. Përveç nëse më lart nuk thuhet ndryshe lidhur me kategoritë e posaçme, dhe varësisht nga Ligji, Rregullorja dhe urdhri gjyqësor, redaktimet e zbatuara në pajtim me kategoritë duhet të jenë të vazhdueshme.

redaktimet e kërkuara. Për aq sa është e mundur dhe përveçse kur përcaktohet ndryshe në Ligj ose Rregullore, një version i redaktuar i kërkesës i duhet dhënë palës marrëse, dhe pala marrëse duhet t'i parashtrojë panelit çfarëdo vërejtje që mund të ketë, në përputhje me rregullat 9 dhe 76.

11. Së fundi, redaktimet e autorizuara nga procedurat e mëhershme të cilat nuk janë të mbuluara nga kategoritë e paraqitura më lart por janë mbajtur për shkak të rregullës 81(1)(a) të Rregullores, nuk janë objekt i miratimit të panelit, por duhet të shënohen me kodin 'F' dhe numrin e çështjes gjyqësore dhe të vendimit.

12. ZPS-ja me respekt kërkon që gjykatësi i procedurës paraprake të miratojë sistemin e redaktimit siç është paraqitur më lart.

Numri i fjalëve (në origjinal): 2,533

/nënshkrim/

Xhek Smith

Prokuror i Specializuar

E enjte, 1 tetor 2020

Në Hagë, Holandë.